

K O N K L U Z I O N
Nr.08- 605/1 dt. 02.07.2013
PËR SHPALLJE TË PËRFUNDIMIMEVE LIDHUR ME
PROJEKTIN ENERGJETIK “FUSHA E LLUKOVËS”

35.Në mbështetje të nenit 50 të Ligjit për vetadministrimin lokal (“Gazeta zyrtare e RM” nr.5/02) si dhe nenit 45 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03),
Kryetari i Komunës Dibër:

K o n k l u d o i

SHPALLEN përfundimet lidhur me projektin energjetik “Fusha e Llukovës, miratuar nga Këshilli i Komunës në seancën e katërtë dt.28.06.2013.

KOMUNA DIBËR
Kryetari,
Ruzhdi Lata d.v.

K O N K L U Z A

Nr.07-558/3 dt. 28.06.2013

36.Në mbështetje të nenit 59 të Statutit të Komunës Dibër”(Kumtesa zyrtare e Komunës” nr. 14/03),

Këshilli i Komunës Dibër në seancën e 4^{të} dt. 28.06.2013 në lidhje me **Projektit Energjetik “Fusha e Llukovës”**, konkludoi:

1.Këshilli i Komunës Dibër, Kryetari i Komunës, shoqatat joqeveritare në Komunë, si dhe mbarë qytetarët e Komunës Dibër **REAGOJNË ASHPËR** dhe janë **KATEGORIKISHT KUNDRA** realizimit të **projektit Energjetik “Fusha e Llukovës”**.

2.Projekti Energjetik “Fusha e Llukovës” ndikon negativisht në ambientin jetësor dhe biodiversitetin në hapësirë që ka vlera mjaft të veçanta, bën devijimin e rrjedhës natyrore të ujërave të lumit Radika dhe rorienton ujin nga Pellgu i Drinit në atë të Vardarit.

3.Ky projekt nuk është në përputhje me Konventën Ndërkombëtare të ujërave (për ndërrimin e rrjedhës së ujërave) sepse ka ndikim në disa shtete.

4.Zvogëlimi i sasisë së ujërave si pasojë e kapjes dhe rorientimit të tyre në Pellgun e Vardarit do të sjell dëme të pa riparueshme për popullatën dhe ambientin në rrjedhën e poshtme të Radikës. Kjo dukshëm do të zvogëlon rrjedhën e Radikës, zvogëlon mundësinë për relizimin e projekteve hidromeliorative për zhvillimin e bujqësisë.

5.Zvogëlimi i sasisë së ujit në rrjedhën e Radikës do të degradojë vlerat e lumit si një ndër lumenjtë më të pastër në vënd dhe grykën piktoreske ku kalon ku Lum dhe si rezultat i kësaj zvogëlohen dhe vlerat turistike të rajonit.

6.Projekti NUK KA argumente të forta ekonomike që do të arsyetonte levërdinë ekonomike në raport me ndikimet dhe pasojat negative dhe nuk jep mundësi për zgjedhjen e alternativave tjera për realizim të qëllimit themelor të Projektit (prodhimin e energjisë elektrike).

7.Përfundimet të dërgohen: **Qeverisë së Republikës Maqedonisë, Qeverisë së Republikës Shqipërisë, Qeverisë së Republikës Kosovës, Bankës Botërore, Ministrisë së ambientit jetësor dhe planifikimin hapsinor, Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve, Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së ujrave, ELEM si dhe institucioneve tjera relavante.**

8. Këto përfundime hynë në fuqi ditën e miratimit dhe do të shpallen në Kumtesën zyrtare të Komunës Dibër.

KËSHILLI I KOMUNËS
Kryetari
Bashkim Mashkulli d.v.

K O N K L U Z I O N
Nr.08- 605/2 dt. 02.07.2013
PËR SHPALLJE TË PROGRAMIT
PËR PLOTËSIMIN E PROGRAMIT VJETOR
PËR PËRPUNIMIN E PLANEVE URBANISTIKE
NË TERRITORIN E KOMUNËS DIBËR PËR VITIN 2013

37.Në mbështetje të nenit 50 të Ligjit për vetadministrimin lokal (“Gazeta zyrtare e RM” nr.5/02) si dhe nenit 45 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03),
Kryetari i Komunës Dibër:

K o n k l u d o i

SHPALLET Programi për plotësimin e programit vjetor për përpunimin e planeve urbanistike në territorin e Komunës Dibër për vitin 2013, miratuar nga Këshilli i Komunës në seancën e katërtë dt.28.06.2013.

KOMUNA DIBËR
Kryetari,
Ruzhdi Lata d.v.

38.Në mbështetje të nenit 17 paragrafi 1 i Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik (“Gazeta zyrtare e R.M.” 51/05, 137/07, 91/09, 124/10, 18/11, 53/11 dhe 144/12) si dhe nenit 27 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës” nr. 14/03),

Këshilli i Komunës Dibër në seancën e 4^{të} dt. 28.06.2013 sjell :

**PROGRAM
PËR PLOTËSIMIN E PROGRAMIT VJETOR
PËR PËRPUNIMIN E PLANEVE URBANISTIKE
NË TERRITORIN E KOMUNËS DIBËR PËR VITIN 2013**

1.Me Këtë Program bëhet plotësimi i Programit vjetor për përpunimin e planeve urbanistike në territorin e Komunës Dibër për vitin 2013.

2.Në tabelën që ka të bëjë me RAJONET KU DO TË REALIZOHET PLANIFIKIMI URBANISTIK gjatë vitin 2013 (“Kumtesa zyrtare e Komunës” nr. 38/12 dhe 3/13): pika 10 plotësohet me një pjesë të bllokut 22 dhe pas pikës 14 shtohet pika 15, si më poshtë:

	PU -kufizimi	sipërfaqja	shuma
10	Ndryshim dhe plotësim i PGJU për qytetin e Dibrës: pas fjalës bloku 20 shtohet : dhe një pjesë e bllokut 22 me kufizim :veri rr. Ekrem Zengo , perëndim rr.Korpusi i 15-të , jug rr. e loparëve dhe në lindje rr. Partizanska	10.30 ha	170.000,00
15	PDU për pjesë të Bllokut 7 dhe 22 me këta kufinj : veri rr.” Xhavit Ushtelenca” ; perëndim rr. „rr.Korpusi i 15-të „ ; jug rr. ,, Eqerem Zengo,, dhe lindje rr. ,, Zeqir Çanka ,, dhe rr. ,, Partizanska ,,	13.30 ha	500.000,00
	Gjithsejt:		670.000,00

3.BURIMET FINANCIARE

-vlera e Buxhetit të Komunës shtohet për 170.000,00 denarë dhe prej 2.950.000,00 dhe bëhet.....	3.120.000,00 denarë
-vlera e personave juridik dhe fizik shtohet për 500.000,00 denarë dhe prej 4.950.000,00 bëhet.....	5.450.000,00 denarë
-vlera e përgjithshme shtohet për 670.000,00 denarë dhe prej 7.900.000,00 denarë bëhet	8.570.000,00 denarë

4.Ky program hyn në fuqi një ditë pas shpalljen në Kumtesën zyrtare të Komunës.

**Nr.07-558/4
28.06.2013
D i b ë r**

**KËSHILLI I KOMUNËS
Kryetar
Bashkim Mashkulli d.v.**

K O N K L U Z I O N
Nr.08- 605/3 dt. 02.07.2013
PËR SHPALLJE TË VENDIMIT PËR VERIFIKIMIN E NEVOJËS PËR
PËRPUNIMIN E DOKUMENTACIONIT URBANISTIK PLANOR LOKAL
PËR PËRCAKTIMIN E LOKALITETIT PËR VENDOSJEN TË
OBJEKTIT TRAFOSTACION NË SHTYLLË NË PK nr.1216
KK KOSOVRAST I EPËRM- KOMUNA DIBËR

39.Në mbështetje të nenit 50 të Ligjit për vetadministrimin lokal (“Gazeta zyrtare e RM” nr.5/02) si dhe nenit 45 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03),

Kryetari i Komunës Dibër:

K o n k l u d o i

SHPALLET vendimi për verifikimin e nevojës për përpunimin e dokumentacionit urbanistik planor lokal për përcaktimin e lokalitetit për ndërtimin e objektit trafostacion në shtyllë në pk. nr.1216/1 KK Kosovrasti i Epërm- Komuna Dibër, miratuar nga Këshilli i Komunës në seancën e katërtë dt.28.06.2013.

KOMUNA DIBËR
Kryetari,
Ruzhdi Lata d.v.

V E N D I M

Nr.07-558/5 dt. 28.06.2013

PËR VERIFIKIMIN E NEVOJËS PËR PËRPUNIMIN E DOKUMENTACIONIT URBANISTIK PLANOR LOKAL PËR PËRCAKTIMIN E LOKALITETIT PËR VENDOSJEN TË OBJEKTIT TRAFOSTACION NË SHTYLLË NË PK nr.1216 KK KOSOVRAST I EPËRM- KOMUNA DIBËR

40.Në mbështetje të nenit 50-a paragrafi 6 të Ligjit për planifikim hapsinor dhe urbanistik (“Gazeta zyrtare e R.M.” nr.51/05, 137/07, 91/09, 124/10, 18/11, 53/11 dhe 144/12) si dhe nenit 27 të Statutit të Komunës të Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës” nr. 14/03), Këshilli i Komunës Dibër në seancën e 4^{të} dt. 28.06.2013 vendosi :

Neni 1

Me këtë vendim verifikohet nevoja për përpunimin e dokumentacionit urbanistik planor lokal në territorin e Komunës Dibër për caktimin dhe përdorimin e hapsirës për vendosjen e trafostacionit në parcelat kadastrale:

Nr. rën.	Parcela kadastrale/ndërtuese	Sipërfaqja	Qëllimi	Parashtrues i iniciativës	Financimi
1	PK nr.1216/1 KK Kosovrasti i Epërm-Komuna Dibër	4.00 m2	Trafostacion në shtyllë	EVN Maqedoni SHA , Shkup QEK Strugë	vetëfinancim

Neni 2

Vendimi për përpunimin e dokumentacionit urbanistik planor lokal në territorin e Komunës Dibër do të paraqesi bazë për përpunimin e dokumentacionit urbanistik.

Me dokumentacionin urbanistik do të bëhet rregullimi i hapsirës me përcaktimin e parcelave ndërtimore jasht kufirit planor për ndërtime të kategorisë së dytë të përcaktuara me Ligjin për ndërtim.

Neni 3

Pas përcaktimit të nevojës për përpunimin e dokumentacionit urbanistik planor lokal dhe hartimin e saj konform nenit 11, 15-a dhe 29 të Ligjit për planifikim hapsinor dhe urbanistik (“Gazeta zyrtare e R.M.” nr.51/05, 137/07, 91/09, 124/10, 18/11, 53/11 dhe 144/12), Komuna do të realizojë prezantim dhe anketë publike që do të zgjasë më së paku 5 ditë.

Neni 4

Pas hartimit të dokumentacionit urbanistik planor lokal, Kryetari i Komunës Dibër me propozim të komisionit nga neni 17 paragrafi 4 i Ligjit për planifikim hapsinor dhe urbanistik sjell Aktvendim me të cilën do të miratohet dokumentacioni urbanistik planor lokal.

Neni 5

Mjetet për hartimin e dokumentacionit urbanistik planor lokal do të sigurohen me vetëfinancim nga parashtuesit të iniciativës.

Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi ditën e tetë nga shpallja në Kumtesën zyrtare të Komunës Dibër.

KËSHILLI I KOMUNËS
Kryetari,
Bashkim Mashkulli d.v.

K O N K L U Z I O N
Nr.08- 605/4 dt. 02.07.2013
PËR SHPALLJE TË VENDIMIT PËR FORMIMIN E KËSHILLIT
KOMUNAL PËR SIGURIMIN E KOMUNIKACIONIT TË RRUGËVE NË
KOMUNËN DIBËR DHE EMËRIMIN E ANËTARËVE TË SAJ

41.Në mbështetje të nenit 50 të Ligjit për vetadministrimin lokal (“Gazeta zyrtare e RM” nr.5/02) si dhe nenit 45 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03),

Kryetari i Komunës Dibër:

K o n k l u d o i

SHPALLET vendimi për formimin e Këshillit komunal për sigurimin e komunikacionit të rrugëve në Komunën Dibër dhe emërimin e anëtarëve të saj, miratuar nga Këshilli i Komunës në seancën e katërtë dt.28.06.2013.

KOMUNA DIBËR
Kryetari,
Ruzhdi Lata d.v.

V E N D I M

Nr.07-558/6 dt. 28.06.2013

**PËR FORMIMIN E KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURIMIN E
KOMUNIKACIONIT TË RRUGËVE NË KOMUNËN DIBËR DHE
EMËRIMIN E ANËTARËVE TË SAJ**

42.Në mbështetje të nenit 412 të Ligjit për siguri në komunikacionin e rrugëve ("Gazeta zyrtare e RM ,, nr. 54/0754/2007, 86/2008, 98/2008, 64/2009, 161/2009 ,36/11 dhe 51/11) si dhe nenit 17 të Statutit të komunës Dibër (Kumtesa zyrtare e komunës Dibër nr 14/03).,

Këshilli i komunës Dibër në seancën e 4^{të} dt. 28.06..2013 vendosi:

Neni 1

Për nevojat e zhvillimit dhe avansimit të arsimit të komunikacionit dhe edukimit të pjesmarrësve në komunikacion, realizimit të bashkëpunimit dhe koordinimit në zhvillimin e punës së komunikacionit-preventivës dhe vetëmbrojtjes, përparimit të sigurisë së përgjithshme të komunikacionit të rrugëve si punë me interes shoqëror, si dhe për shkak të inicimit dhe propozimit të masave të nevojshme për siguri më të madhe në komunikacionin e rrugëve, në komunën Dibër krijohet Këshilli komunal për siguri të komunikacionit të rrugëve.

Neni 2

Për kryetar dhe anëtarë të Këshillit komunal për siguri të komunikacionit të rrugëve në komunën Dibër emërohet :

-Abdyl	Koleci	-kryetar
-Arben	Dumani	-anëtar,
-Afërdita	Kërçishta	-anëtar,
-Adraman	Tozlluku	-anëtar,
-Agim	Dibra	-anëtar,
-Bashkim	Mashkulli	-anëtar,
-Dejan	Vapski	-anëtar,
-Petrit	Paçuku	-anëtar
-Reshat	Qormemeti	-anëtar
-Ajaz	Avmedoski	-anëtar dhe
-Ramadan	Elmazoski	-anëtar

Neni 3

Detyrat e këshillit nga neni 1 të këtij vendimi janë:

- Përparimi i punëve që kanë të bëjnë me sigurinë në komunikacionin rrugor.

- Përparimin e kulturës dhe arsimit në komunikacion të pjesëmarrësve në komunikacion dhe zhvillimin e punës edukative në komunikacion të institucioneve parashkollore dhe shkollave.
- Realizimi i bashkëpunimit dhe bashkërendimin në punën preventive të organeve të shtetit, institucioneve, personave juridik, dhe subjekteve të tjera në lidhje me çështjen e vetëmbrojtjes në fushën e komunikacionit rrugor.
- Organizimi dhe pjesëmarrja në aksione dhe manifestime me karakter edukues dhe preventiv nga fusha e komunikacionit.
- Nxitja, zhvillimi dhe ndihma e punës kërkimore-shkencore në fushën e komunikacionit rrugor.
- Furnizimi dhe botimi i publikimeve edukuese dhe filmimin e filmave nga fusha e komunikacionit.
- Organizimi i tubimeve shkencore dhe profesionale për punë nga fusha e sigurisë në komunikacionin rrugor dhe bashkëpunimin me mjetet e informimit publik, me qëllim të informimit me kohë, gjithpërfshirës dhe objektiv të qytetarëve për masat e avancimit të preventivës dhe sigurisë në komunikacionin rrugor.

Neni 4

Anëtarët e këshillit për siguri të komunikacionit të rrugëve në komunën Dibër emërohen në kohë për 4 vjet.

Neni 5

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi pushon të vlejë vendimi Nr 07-624/7 dt. 30.06.2009 dhe aktvendimi nr.07-1068/6 dt. 23.11.2009 për shkarkim dhe emërim të anëtarëve të Këshillit komunal për siguri të komunikacionit të rrugëve në Komunën Dibër.

Neni 6

Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit, dhe do të shpallet në "Kumtesën zyrtare të komunës Dibër".

KËSHILLI I KOMUNËS
Kryetari
Bashkim Mashkulli d.v.

K O N K L U Z I O N
Nr.08- 605/5 dt. 02.07.2013
PËR SHPALLJE TË VENDIMIT PËR
PËRCAKTIMIN E PRIORITETIT TË PROJEKTIT
“REKONSTRUIM I RRUGËS LOKALE BANISHT DERI TE RRUGA
RAJONALE 1202”-KOMUNA DIBËR.

43.Në mbështetje të nenit 50 të Ligjit për vetadministrimin lokal (“Gazeta zyrtare e RM” nr.5/02) si dhe nenit 45 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03),
Kryetari i Komunës Dibër:

SHPALLET vendimi për përcaktimin e prioritetit të projektit “Rekonstruim i rrugës lokale Banisht deri te rruga rajonale 1202”-Komuna Dibër, miratuar nga Këshilli i Komunës në seancën e katërtë dt.28.06.2013.

KOMUNA DIBËR
Kryetari,
Ruzhdi Lata d.v.

VENDIM
Nr.07-558/7 dt. 28.06.2013
PËR PËRCAKTIMIN E PRIORITETIT TË PROJEKTIT

44.Në mbështetje të nenin 36, paragrafi 1, pika 15 të Ligjit për vetqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e R.M. nr 5/02) dhe nenit 59 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e komunës Dibër nr.14/03),

Këshilli i Komunës Dibër në seancën 4^{të} datë 28.06.2013 vendosi:

Neni 1

Me këtë vendim Këshilli i Komunës Dibër jep prioritet projektit :
“REKONSTRUIM I RRUGËS LOKALE BANISHT DERI TE RRUGA RAJONALE 1202”-KOMUNA DIBËR.

Neni 2

Ky vendim hyn në fuqi një ditë pas shpalljes në “ Kumtesën zyrtare të komunës Dibër.

KËSHILLI I KOMUNËS
Kryetari,
Bashkim Mashkulli d.v.

K O N K L U Z I O N
Nr.08- 605/6 dt. 02.07.2013
PËR SHPALLJE TË VENDIMIT PËR
DHËNIEN E PËLQIMIT PËR QËLLIMIN E
INVESTIMIT“REKONSTRUIM I RRUGËS LOKALE BANISHT DERI TE
RRUGA RAJONALE 1202”-KOMUNA DIBËR

45.Në mbështetje të nenit 50 të Ligjit për vetadministrimin lokal (“Gazeta zyrtare e RM” nr.5/02) si dhe nenit 45 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03),

Kryetari i Komunës Dibër:

SHPALLET vendimi për dhënie pëlqim për qëllimin e investimit për realizimin e projektit “Rekonstruim i rrugës lokale Banisht deri te rruga rajonale 1202”-Komuna Dibër, miratuar nga Këshilli i Komunës në seancën e katërtë dt.28.06.2013.

KOMUNA DIBËR
Kryetari,
Ruzhdi Lata d.v.

VENDIM
Nr.07-558/8 dt.28.06.2013
PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR
QËLLIMIN E INVESTIMIT

46.Në mbështetje të nenin 36, paragrafi 1, pika 15 të Ligjit për vetqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e R.M. nr 5/02) dhe nenit 59 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e komunës Dibër nr.14/03),

Këshilli i Komunës Dibër në seancën 4^{të} datë 28.06.2013 vendosi:

Neni 1

Me këtë vendim Këshilli i Komunës Dibër jep pëlqim për qëllimin e investimit me qëllim realizimin e projektit : **“REKONSTRUIM I RRUGËS LOKALE BANISHT DERI TE RRUGA RAJONALE 1202”-KOMUNA DIBËR.**

Neni 2

Ky vendim hyn në fuqi një ditë pas shpalljes në “ Kumtesën zyrtare të komunës Dibër.

KËSHILLI I KOMUNËS
Kryetari,
Bashkim Mashkulli d.v.

K O N K L U Z I O N
Nr.08- 605/7 dt. 02.07.2013
PËR SHPALLJE TË VENDIMIT PËR
PËRCAKTIMIN E PRIORITETIT TË PROJEKTIT “RRUGA LOKALE
f.KOSOVRAS I POSHTËM-KOMUNA DIBËR

47.Në mbështetje të nenit 50 të Ligjit për vetadministrimin lokal (“Gazeta zyrtare e RM” nr.5/02) si dhe nenit 45 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03),

Kryetari i Komunës Dibër:

SHPALLET vendimi për përcaktimin e prioritetit të projektit “Rruga lokale f.Kosovrast i Poshtëm-Komuna Dibër, miratuar nga Këshilli i Komunës në seancën e katërtë dt.28.06.2013.

KOMUNA DIBËR
Kryetari,
Ruzhdi Lata d.v.

**VENDIM
Nr.07-558/9 dt. 28.06.2013
PËR PËRCAKTIMIN E PRIORITETIT TË PROJEKTIT**

48.Në mbështetje të nenin 36, paragrafi 1, pika 15 të Ligjit për vetqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e R.M. nr 5/02) dhe nenit 59 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e komunës Dibër nr.14/03),

Këshilli i Komunës Dibër në seancën 4^{të} datë 28.06.2013 vendosi:

Neni 1

Me këtë vendim Këshilli i Komunës Dibër jep prioritet projektit :
“RRUGA LOKALE f.KOSOVRAST I POSHTËM-KOMUNA DIBËR

Neni 2

Ky vendim hyn në fuqi një ditë pas shpalljes në “ Kumtesën zyrtare të komunës Dibër.

**KËSHILLI I KOMUNËS
Kryetari,
Bashkim Mashkulli d.v.**

K O N K L U Z I O N
Nr.08- 605/8 dt. 02.07.2013
PËR SHPALLJE TË VENDIMIT PËR DHËNIEN
E PËLQIMIT PËR QËLLIMIN E INVESTIMIT“ RRUGA LOKALE
f.KOSOVRAS T I POSHTËM-KOMUNA DIBËR

49.Në mbështetje të nenit 50 të Ligjit për vetadministrimin lokal (“Gazeta zyrtare e RM” nr.5/02) si dhe nenit 45 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03),

Kryetari i Komunës Dibër:

SHPALLET vendimi për dhënie pëlqim për qëllimin e investimit me qëllim realizimin e projektit “ Rruga lokale f.Kosovrast i Poshtëm-Komuna Dibër, miratuar nga Këshilli i Komunës në seancën e katërtë dt.28.06.2013.

KOMUNA DIBËR
Kryetari,
Ruzhdi Lata d.v.

VENDIM
Nr.07-558/10 dt. 28.06.2013
PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR
QËLLIMIN E INVESTIMIT

50.Në mbështetje të nenin 36, paragrafi 1, pika 15 të Ligjit për vetqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e R.M. nr 5/02) dhe nenit 59 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e komunës Dibër nr.14/03),

Këshilli i Komunës Dibër në seancën 4^{të} datë 28.06.2013 vendosi:

Neni 1

Me këtë vendim Këshilli i Komunës Dibër jep pëlqim për qëllimin e investimit me qëllim realizimin e projektit : “ **RRUGA LOKALE f.KOSOVRAST I POSHTËM-KOMUNA DIBËR**

Neni 2

Ky vendim hyn në fuqi një ditë pas shpalljes në “ Kumtesën zyrtare të komunës Dibër.

KËSHILLI I KOMUNËS
Kryetari,
Bashkim Mashkulli d.v.

K O N K L U Z I O N
Nr.08- 605/9 dt. 02.07.2013
PËR SHPALLJE TË AKTVENDIMIT PËR SHKARKIM DHE EMËRIM
TË PËRFAQËSUESVE TË KOMUNËS DIBËR NË KËSHILLIN
SHKOLLOR TË SHMK 28 NËNTORI DIBËR

51.Në mbështetje të nenit 50 të Ligjit për vetadministrimin lokal (“Gazeta zyrtare e RM” nr.5/02) si dhe nenit 45 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03),

Kryetari i Komunës Dibër:

SHPALLET aktvendimi për shkarkim dhe emërim të përfaqësuesve të Komunës Dibër në Këshillin e Shkollës së Mesme Komunale 28 Nëntori Dibër, miratuar nga Këshilli i Komunës në seancën e katërtë dt.28.06.2013.

KOMUNA DIBËR
Kryetari,
Ruzhdi Lata d.v.

A K T V E N D I M
Nr. 07-558/11 dt.28.06.2013
PËR SHKARKIM DHE EMËRIM TË PËRFAQËSUESVE
TË KOMUNËS DIBËR NË KËSHILLIN SHKOLLOR TË
SHMK 28 Nëntori DIBËR

52.Komunës Dibër ("Kumtesa zyrtare e Komunës"nr.14/03) në lidhje me nenin 39 paragrafi 5 të Ligjit për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për arsim të mesëm ("Gazeta zyrtare e RM"nr.67/04),

Këshilli i Komunës Dibër në seancën e 4^{të} dt.28.06.2013 vendosi:

1.Nga Këshilli shkollor i SHMK 28 Nëntori Dibër si përfaqësues të Komunës Dibër shkarkohen : Ylli Mirzo, Bashkim Pjeça, Aslan Zeqiroski.

2.Përfaqësues të Komunës Dibër në Këshillin shkollor të SHMK 28 Nëntori Dibër emërohen :

-Mustafa	Mashkulli
-Bashkim	Pjeça
-Aqif	Imeroski

3.Ky aktvendim hyn në fuqi ditën e miratimit dhe do të shpallet në "Kumtesën zyrtare të Komunës".

KËSHILLI I KOMUNËS
Kryetari,
Bashkim Mashkulli d.v.

P Ë R B A J T J A

35	Konkluzion për shpallje të përfundimeve lidhur me projektin energjetik “Fusha e Llukovës”	_____	55
36	Përfundime lidhur me projektin energjetik “Fusha e Llukovës”	_____	56
37	Konkluzion për shpallje të Programit për plotësimin e programit vjetor për përpunimin e planeve urbanistike në territorin e Komunës Dibër për vitin 2013	_____	57
38	Program për plotësimin e programit vjetor për përpunimin e planeve urbanistike në territorin e Komunës Dibër për vitin 2013	_____	58
39	Konkluzion për shpallje të vendimit për përcaktimin e nevojës për përpunimin e dokumentacionit urbanistik planor lokal për përcaktimin e lokalitetit për ndërtimin e objektit trafostacion në shtyllë në pk. nr.1216/1 KK Kosovrasti i Epërm- Komuna Dibër	_____	59
40	Vendim për përcaktimin e nevojës për përpunimin e dokumentacionit urbanistik planor lokal për përcaktimin e lokalitetit për ndërtimin e objektit trafostacion në shtyllë në pk. nr.1216/1 KK Kosovrasti i Epërm- Komuna Dibër	_____	60
41	Konkluzion për shpallje të vendimit për formimin e Këshillit komunal për sigurimin e komunikacionit rrugëve në Komunën Dibër dhe emërimin e anëtarëve të saj	_____	61
42	Vendim për formimin e Këshillit komunal për sigurimin e komunikacionit rrugëve në Komunën Dibër dhe emërimin e anëtarëve të saj	_____	62
43	Konkluzion për shpallje të vendimit për përcaktimin e prioritetit të projektit “Rekonstruim i rrugës lokale Banisht deri te rruga rajonale 1202”-Komuna Dibër	_____	64
44	Vendim për përcaktimin e prioritetit të projektit “Rekonstruim i rrugës lokale Banisht deri te rruga rajonale 1202”-Komuna Dibër	_____	65
45	Konkluzion për shpallje të vendimit për dhënie pëlqim për qëllimin e investimit për realizimin e projektit “Rekonstruim i rrugës lokale Banisht deri te rruga rajonale 1202”-Komuna Dibër	_____	66
46	Vendimi për dhënie pëlqim për qëllimin e investimit për realizimin e projektit “Rekonstruim i rrugës lokale Banisht deri te rruga rajonale 1202”-Komuna Dibër	_____	67
47	Konkluzion për shpallje vendimit për përcaktimin e prioritetit të projektit “Rruga lokale f.Kosovrast i Poshtëm-Komuna Dibër	_____	68
48	Vendim për përcaktimin e prioritetit të projektit “Rruga lokale f.Kosovrast i Poshtëm-Komuna Dibër	_____	69
49	Konkluzion për shpallje të vendimit për dhënie pëlqim për qëllimin e investimit me qëllim realizimin e projektit : “ Rruga lokale f.Kosovrast i Poshtëm-Komuna Dibër	_____	70
50	Vendim për dhënie pëlqim për qëllimin e investimit me qëllim realizimin e projektit : “ Rruga lokale f.Kosovrast i Poshtëm-Komuna Dibër	_____	71
51	Konkluzion për shpallje të aktvendimit për shkarkim dhe emërim të përfaqësuesve të Komunës Dibër në Këshillin e shkollës së mesme komunale 28 Nëntori Dibër	_____	72
52	Aktvendim për shkarkim dhe emërim të përfaqësuesve të Komunës Dibër në Këshillin e shkollës së mesme komunale 28 Nëntori Dibër	_____	73

PËRGATITI : KËSHILLI I KOMUNËS